



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

### *Konferenca e Kryetarëve*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.07.2018 ora 12.00

**Drejton mbledhjen:**

**Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 9 korrik - fund sesioni II 2018.
2. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 9 - 23 korrik 2018.

#### **Të pranishëm:**

Gramoz Ruçi - Kryetar i Kuvendit  
Senida Mesi - Zëvendëskryeministre  
Taulant Balla - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste  
Ermonela Felaj - Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare  
Mimi Kodheli - Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme  
Erion Braçe - Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave  
Eduard Shalsi - Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin  
Ulsi Manja - Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

#### **Mungojnë:**

Vasilika Hysi - Nënkyetare e Kuvendit  
Edi Paloka - Nënkyetar i Kuvendit  
Edmond Spaho - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike  
Petrit Vasili - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim/  
Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë  
Fatmir Mediu - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane  
Genc Pollo - Kryetar i Komisionit për Integrimin Europian  
Albana Vokshi - Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

#### **Marrin pjesë:**

Mimoza Pano - Drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare  
Lefterije Luzi - Drejtore e Shërbimit të Komisioneve

## HAPET MBLEDHJA

**Gramoz Ruçi** – Hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me rend dite: Miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 9 korrik - fund sesioni II-të 2018 dhe miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 9 - 23 korrik 2018.

Me projektprogramin dhe projektkalendarin jeni njohur paraprakisht në mënyrë elektronike.

Projektprogrami përfshirë të gjitha çështjet e depozituara në Kuvend si projektligje, projektvendime, raporte vjetore të institucioneve etj. Pjesë e këtij programi do të jenë edhe kërkesat e ardhura nga organet kushtetuese si, Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për shtesa apo ndryshime në strukturën organizative të tyre.

Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancë plenare. Janë parashikuar, përveç seancës që do të zhvillohet ditën e nesërme nga kalendari i kaluar, të zhvillohen edhe 3 seanca plenare përkatësisht në datat:

- 9 korrik, ora 10.00 ditën e hënë
- 19 korrik, ora 10.00 ditën e enjte
- 23 korrik, ora 10.00 ditën e hënë

Çfarë sugjerimesh keni për materialet e paraqitura?

**Mimi Kodheli** – Faleminderit zoti Kryetar. Komisioni i Politikës së Jashtme është komision për dhënie mendimi lidhur me ratifikimin e dy marrëveshjeve, përkatësisht 1) Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES)” dhe 2. Projektligji “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”, të cilat i takojnë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Bazuar në kalendar, këto dy marrëveshje duhet të përfshihen në rendin e ditës të seancës së ditës së hënë, datë 9 korrik, në një kohë që nuk kanë kaluar në komisionin tonë. Fola me kryetaren e komisionit të Sigurisë Kombëtare, që është dhe komision përgjegjës zonjën Felaj, e cila ka planifikuar të bëjë një mbledhje të komisionit respektiv, në një kohë që mua më rezulton e pa mundur që edhe ne të zhvillojmë mbledhje ditën e premtë, pasi nuk arrijmë të sigurojmë dot kuorumin dhe marrëveshjet nuk bëhen dot gati për seancën e të hënës.

**Mimoza Pano** – Sipas Rregullores, neni 32, pika 3 e saj, komisionet mund të mbledhen edhe gjatë zhvillimit të seancës plenare me miratimin e drejtuesit të seancës, Kryetarit të Kuvendit.

**Mimi Kodheli** – Dakord atëherë, po e lëmë për nesër në seancë për të zhvilluar mbledhje.

**Ermonela Felaj** – Do të doja të shtoja se, nësi komisioni i Sigurisë jemi komision për dhënie mendimi dhe jo përgjegjës në lidhje me projektligjin “Kodi Ajror në Republikën e Shqipërisë”. Kemi folur me shërbimet e Kuvendit në lidhje me Kodin Ajror, që ndoshta do të ishte më e përshtatshme që mos ta përfshinim tani në kalendar.

Do të doja të pyesja Zëvendëskryeminstren zonjën Senida Mesi në lidhje me projektligjin “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë” nëse ka urgjencë shqyrtimi i këtij projektligji, i cili është parashikuar në kalendar për t’u shqyrtuar në seancën e datës 19 korrik 2018. Nga komisioni i Integritimit më thonë se mungon tabela e përputhjes dhe nga ana tjetër ligji është shumë i ngarkuar me terminologji teknike dhe ndoshta do të na marrë shumë kohë. Është e nevojshme që ta kalojmë tani, apo ta shtyjmë për në shtator?

**Senida Mesi** – Në Këshill të Ministrave nuk kam dëgjuar për ndonjë urgjencë, por do të konsultohem edhe me Kryeministrin për këtë problematikë në lidhje me projektligjin dhe do t’ju kthej përgjigje, si Juve zoti Kryetar edhe zotit Balla, Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

**Gramoz Ruçi** – Duhet të bëni një kujdes zonja Zëvendëskryeministre, veçanërisht pas daljes së vendimit të fundit të Këshillit të Bashkimit Europian. Tradicionalisht, por veçanërisht këtë vit kalendarik, duhet të keni në qendër të vëmendjes tabelën e përputhshmërisë së legjislacionit. Këtë ta keni të prerë dhe të mos ketë absolutisht asnjë lëshim në këtë drejtim.

Edhe Ju si Zëvendëskryeministre për marrëdhëniet me parlamentin edhe me Ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme dhe përfaqësuesit e saj, duhet të ktheheni në gardianë të kësaj çështjeje përpara se ligji të depozitohet në Parlament. Është një gjë shumë e mirë që Komisionin e Integritimit, që ndjek këtë çështje e ka opozita, por pavarësisht anëtarët tanë duhet të bëhen gardianë të kësaj çështjeje. Kjo është një nga funksionet tona si parlamentarë, prandaj të mos kemi fjalë. Në qoftë se do të mungojë tabela e përputhshmërisë do të kthehen ligjet mbrapsht, ta dini këtë, pasi nuk mund të bëjmë sikur nuk e di, sikur nuk e shikon, sikur s’e dëgjon, sikur s’e kupton, as deputetët, as komisionet dhe as seanca e parlamentit. Këtë duhet ta keni të prerë si Qeveri! Tjetër?

**Taulant Balla** – Zonja Pano, të gjitha këto marrëveshjet janë përfshirë në tre seancat e parashikuara?

**Mimoza Pano** – Të gjitha marrëveshjet që janë depozituar në Kuvend deri më sot dhe të gjitha projektligjet që kanë qenë në programin e mëratshëm dhe ato të mbarturat janë parashikuar në tre seancat e parashikuara në kalendar deri në datën 23 korrik 2018. Në këtë kalendar do të përfshihen edhe projektligjet që kanë mbetur nga kalendari aktual, duke u mbartur në kalendarin e ri.

**Gramoz Ruçi** – Dakord, sugjerime dhe mendime të tjera ka? Meqenëse sugjerime të tjera nuk ka t'i paraqesim seancës plenare programin dhe kalendarin për 3-javët në vazhdim. Faleminderit mbledhja mbyllet.

**MBLEDHJA MBYLLET**